

## RRETH TOGFJALËSHAVE TË QËNDRUESHËM NË GJUHËN SHQIPE

Suela KOÇA

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë  
Departamenti i Gjuhësisë  
Tiranë

**Përmbajtja e shkurtër:** Me pikëpamjet, këndvështrimet a qasjet e shumta nga studiues të ndryshëm tashmë janë hedhur bazat teorike rreth kategorisë së togfjalëshave të qëndrueshëm në gjuhën shqipe. Në punim përvijohet përpjekja për të paraqitur në mënyrë të plotë përcaktimin e kufijve të frazeologjisë shqipe në gjuhësinë shqiptare, nisur nga parimet tashmë të pranuar si: frazeologjia si një degë më vete e gjuhësisë dhe jo si pjesë e leksikologjisë; frazeologjia si dije që merret me një nënsistem të gjuhës dhe jo me njësi frazeologjike të izoluara; si dije që merret me të gjitha llojet e togfjalëshave të qëndrueshëm; nga togfjalëshat a shprehjet e qëndrueshme dallohen më qartë disa klasa; dallimi kryesor midis klasave është semantik: idiomat frazeologjike kanë kuptime plotësisht ose pjesërisht të pamotivueshme etj.

Për konceptin e përmbajtjen e termit “togfjalësh i qëndrueshëm” në gjuhësinë shqiptare ka interpretime teorike e këndvështrime të ndryshme, që dalin edhe përmes përkufizimeve shkencore në vepra, studime e tekste mësimore. Këtu përmendim veçanërisht ndihmesat e studiuesve Spiro Floqi, Androkli Kostallari, Jani Thomai, Menella Totoni etj., të mbështetura teorikisht sipas fushave të studimit: sintaksë, fjalëformim, leksikologji e semantikë. Që këtu mund të theksojmë që ky vështrim i shtrirë në truallin e disa fushave gjuhësore (përveç kushtëzimeve jashtëgjuhësore) është metodologjikisht i drejtë e frytdhënës. Gjithsesi mbetet një temë me shumë çështje ende për diskutim.

Lidhur me këto vështrime, janë trajtuar edhe çështje të frazeologjisë, të strukturës së njësive frazeologjike, të kufijve, të dallimeve nga njësi të tjera njësi gjuhësore (nga fjala e përbërë a e përngjitur, nga togfjalëshi i lirë e nga fjalia), çështje të zhvillimeve në përbërje e në kuptim, të klasifikimit të njësive frazeologjike sipas motivimit semantik, por edhe sipas formës, të përkufizimit të idiomave si një grup i veçantë i togfjalëshave të qëndrueshëm frazeologjikë, si edhe mjaft çështje të tjera të diskutueshme për kriteret e përkufizimit të këtyre njësive, si ngurosjë, idiomatika, qëndrueshmëria, funksioni si një fjalë e vetme a funksioni sintaksor, lidhjet e përdorimit në kontekst etj. Këtu vërehet para së gjithash synimi i njëjtë i disa autorëve që, në klasën e madhe të togfjalëshave të qëndrueshëm, të veçohet kategoria e togfjalëshave frazeologjikë nëpërmjet karakteristikave të strukturës formale dhe të dallimeve semantike, që nxirren duke i krahasuar me togfjalëshat e tjerë të qëndrueshëm dhe me ndërtimin e një “skeme” specifike për frazeologjinë gjuhësore me tipare leksiko-sintaksore, me klasifikim të brendshëm dhe me veçori të tjera të përmbajtjes e të funksionit në gjuhë, që e përlligjin ndarjen e tyre si kategori më vete mjetesh të shprehjes gjuhësore. Në këtë studim i përkushtohemi më shumë pikërisht frazeologjisë gjuhësore, me një vështrim të përgjithshëm, duke shtruar në krye disa teza studimi të karakterit teorik, kryesisht për ndihmesat teorike rreth kësaj fushe.

Na vjen për dore që punimin ta paraprijmë me një pjesë të shkurtër të shkëputur nga romani “Kronikë në gur” i shkrimtarit, Ismail Kadare: “Fjalë dhe shprehje, që i kisha dëgjuar me qindra herë, befas, filluan të më tingëllonin me një kuptim të ri. Fjalët filluan të çliroheshin nga kuptimi i tyre i përditshëm. Shprehjet e krijuara nga dy-tri fjalë filluan të zbërtheshin në mënyrë torturuese. Në qoftë se do të dëgjoja që dikush thoshte “më zien koka”, mendja ime, kundër vullnetit tim, aty për aty përfytyronte një kokë që ziente si vorbë me fasule. Fjalët kishin një energji të caktuar, në gjendjen e tyre të ngrirë. Tani, kur ato filluan të shkrijnë, të zbërthehen, po lëshonin një energji të tmerrshme. Kisha frikë nga zbërthimi i tyre”<sup>1</sup>. Shkrimtari është ndër të parët që e kupton vlerën e këtyre shprehjeve të krijuara nga dy-tri fjalë. Pikërisht këto njësi më të gjera se fjala, togfjalësha a shprehje ndonjëherë edhe me strukturë fjalie, janë si barasvlerës të fjalëve. Secili prej këtyre togfjalëshave funksionon në gjuhë njësoj si fjala, duke shërbyer për shënimin e një koncepti të vetëm, të një sendi a dukurie, të marrë si entitet më vete. Këto njësi përbëjnë edhe veçanti në gjuhë, në krahasim me gjuhë të tjera, ngaqë vijnë si mishërim i identitetit dhe i

<sup>1</sup> I. Kadare, *Kronikë në gur*, Tiranë, Onufri, f. 132-133.

origjinalitetit të secilës gjuhë.

Sipas Noam Çomskit studimi i gjuhës synon zbulimin e parimeve dhe të elementeve të përbashkëta brenda kornizës së gjuhës njerëzore, që do të thotë të gramatikës universale. Kjo “gramatikë” specifikon një sërë gramatikash bazë (bërthamë)<sup>2</sup>. Ajo që pasqyrohet në mendjen e një individi do të ishte një gramatikë bazë, me një sërë elementesh a strukturash që qëndrojnë më në periferi të kësaj bërthame. Vështruar sipas kësaj pikëpamjeje, togfjalëshat e qëndrueshëm (përfshirë edhe idiomat e përgjithësisht njësitë frazeologjike) i përkasin kësaj periferie dhe jo bërthamës së sistemit të gjuhës. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se togfjalëshat e qëndrueshëm janë dukuri periferike dhe të parëndësishme. Nëpërmjet studimit të këtyre togjeve mund të mësojmë më shumë rreth vetë thelbit të gjuhës.

Në studimet bashkëkohore edhe mënyra e qasjes ndaj këtyre njësive ka ndryshuar. Kjo mund të lidhet me faktin që shumë gjuhëtarë e kanë kuptuar se togfjalëshat e qëndrueshëm (me kuptim të figurshëm ose të drejtpërdrejtë) a ndërtime të ngjashme përbëjnë një pjesë të madhe të njohjeve tona për gjuhën në përgjithësi dhe janë tipar i qenësishëm e i përhershëm i gjuhës. Igor Melçuk mëton se “njerëzit nuk flasin me fjalë, ata flasin me frazema”<sup>3</sup>.

Pas kësaj e ndiejmë të nevojshme të hedhim një vështrim mbi ndihmesat teorike për termin “togfjalësh i qëndrueshëm”. Që këtu po nënvizojmë që ndërmjet autorëve të ndryshëm, që janë marrë me këtë kategori gjuhësore, ka dhënie e marrje të ndërsjella, edhe me literaturën e huaj, ka dallime e nuanca të holla qëndrimesh që rrezatohen në karakterizimet e njësive konkrete, sikundër ka edhe përputhje mendimesh të përgjithshme a më të veçanta, si, fjala vjen, njohja e togfjalëshave të qëndrueshëm si njësi leksiko-sintaksore, pranimi i tipareve që i afrojnë me fjalën si njësi leksiko-semantike, përputhja në disa kritere identifikimi, si qëndrueshmëria, pjesërisht ngurosja dhe idiomatika etj., të cilat do të zbulohen në paraqitjen e tyre të mëtejshme.

Kur studiojmë togfjalëshat e qëndrueshëm, i referohemi konceptit të një përbërësi leksikor brenda një kornize gramatikore. Tradita gjenerative e kërkimit u ndikua nga pikëpamja blumfildiane për leksikun si një

<sup>2</sup> N. Chomsky, *Lectures on Government and Binding*, Foris, Dordrecht, 1981, cited from E. Everaert, F. J. Van der Linden, A. Schenk, & R. Schreuder (eds.), *Idioms: Structural and Psychological perspective*, Hillsdale, New Jersey: Lawrence Erlbaum, 1995, f. 3.

<sup>3</sup> I. Mel'čuk, *Phrasemes in Language and Phraseology in Linguistics*, in E. Everaert, F. J. Van der Linden, A. Schenk, & R. Schreuder (eds.), *Idioms: Structural and Psychological perspective*, Hillsdale, New Jersey: Lawrence Erlbaum, 1995, f. 167.

“shtesë e gramatikës”, një listë parregullsish bazë. Pas viteve '70 të shekullit XX kjo pikëpamje ndryshoi. Leksiku është bërë më i rëndësishëm në teori të ndryshme gjuhësore, madje edhe përtej disiplinave të ndryshme gjuhësore.

Kur flitet për termin “togfjalësh” në gjuhën shqipe, kemi një konceptim, pak a shumë, të përbashkët nga gjuhëtarët tanë. Kështu, Spiro Floqi shprehet se fjalia, kur është e zbërthyeshme, e analizueshme, është sajuar prej fjalësh të bashkuara nga pikëpamja gramatikore e kuptimore në njësi të caktuara sintaksore, në togfjalësha. Dihet që termi gjuhësor *togfjalësh* është sajuar prej gjuhëtarëve si një kompozitë e përbërë prej emrave “tog” dhe “fjalësh”. Përtej kuptimit të drejtpërdrejtë të rrafshit të parë fjalëkrijues, ai ka fituar vlerën e termit gjuhësor, sepse nuk tregon një grumbull, një grup, një tog çfarëdo fjalësh, por një tog të caktuar. Nga pikëpamja e formimit termi *togfjalësh* ka ngjashmëri me termat përkatës të disa gjuhëve të tjera indoevropiane (krhs. fr. *groupe de mots*, gjer. *wortgruppe*, angl. *word-group* etj.), por brendia e termit “togfjalësh” nuk përputhet plotësisht me ato të asnjë prej termave nga, ndoshta, është kalkuar, as me atë të termave të tjerë në gjuhësinë botërore. Sipas S. Floqit, “Një togfjalësh përbëhet së paku prej dy fjalësh, por jo prej dy fjalësh çfarëdo, po prej dy fjalësh shënuese... Fjalët shënuese janë gjymtyrët e tij, ndërsa fjalët shërbyese (nyjat, parafjalët etj.) janë, krahas trajtave të fjalëve, mjetet e lidhjes së togfjalëshit, por jo gjymtyrët e tij... Togfjalëshat kanë gjithmonë strukturë dygjymtyrëshe”. Mendojmë që S. Floqi ka të drejtë kur shprehet se brendia e termit “togfjalësh” nuk përputhet plotësisht me termat përkatës në gjuhët e tjera. Fjala vjen, në anglishte pranohen si togfjalësha edhe lidhje fjalësh shërbyese me fjalë shënuese, si parafjalë + emër: *by heart*, *of course* etj. Sipas po këtij autori, togfjalëshat janë të lirshëm dhe të qëndrueshëm (frazelogjikë). Togfjalëshat e lirshëm sajohen lirisht gjatë ligjërimit në saje të vetive leksiko-gramatikore të gjymtyrëve, dhe këto janë objekt i sintaksës; togfjalëshat e qëndrueshëm, frazeologjikë, si ekuivalente të një fjale të vetme, jepen në fjalorin e një gjuhe ashtu si edhe fjalët dhe prandaj nuk studiohen nga sintaksa, por nga leksikologjia, më saktë nga frazeologjia (*bëj qejf* / *dëfrej* etj.)<sup>4</sup>.

Me këtë konceptim pajtohet edhe M. Totoni, sipas të cilit, njësia frazeologjike është kategori leksikologjike; si e tillë lidhet me sferën e kuptimit dhe hyn në marrëdhënie me kategori të tjera kuptimore. Njësia frazeologjike ka strukturë sintaksore, e cila vetëm nga njësia dhe qëndrue-

<sup>4</sup> S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, në “Konferenca e dytë e studimeve Albanologjike”, Tiranë, 1969; resp. f. 183, 184, 185.

shmëria kuptimore afrohet me *fjalën*. Ashtu si fjala, njësia frazeologjike ka rrafshin e përmbajtjes, kuptimin, me të cilin merret leksikologjia, dhe rrafshin e shprehjes, strukturën, me të cilin merret sintaksa. Kjo strukturë nuk mund të jetë diçka e ndryshme nga struktura e lirë që ka shërbyer si model: çdo njësi frazeologjike ndërtohet në bazë të lidhjeve që veprojnë në gjuhë, pavarësisht nga kuptimi leksikor i drejtpërdrejtë a i figurshëm i fjalëve që hyjnë në lidhje. Kjo lidhje mund të errësohet në kushtet e një përdorimi të shpeshtë e të gjatë, vetëm në qoftë se dobësohet a errësohet kuptimi leksikor ose kuptimi gramatikor, të paktën i një përbërësi të njësisë frazeologjike. Në këto kushte, struktura frazeologjike nuk është më e lirë, tashmë ajo nuk është më strukturë sintaksore, ajo ka fituar cilësi të reja që i afrohen pjesës së ligjëratës, pra, i përket rrafshit *morfologjik*.

Për *ngurosjen* e gjymtyrëve në një formë të caktuar, M. Totoni nuk sheh ndonjë veçori të strukturave frazeologjike dhe, për më tepër, një veçori të përgjithshme të tyre. Sipas tij, gjymtyra emërore me formën e saj shpreh marrëdhënien me foljen dhe me kuptime të tjera gramatikore, që përcaktohen nga struktura sintaksore e semantike e fjalisë. Prandaj zëvendësimi i formës së emrit, edhe në qoftë se nuk e ndryshon marrëdhënien, mund të japë shkas për lëvizje në strukturën semantike të fjalisë, të cilat mund të sjellin si pasojë ndryshimin e kuptimit tërësor të saj. Këtu vjen shembulli i njësisë frazeologjike *i jap besë* “besoj” dhe *i jap besën* “e siguroj për diçka”, ku kundërvënia e formave të kallëzores, sipas kuptimit gramatikor i përgjithësuar a nocionor – i individualizuar, është baza e lindjes së kuptimeve frazeologjike.

Edhe *paplotësinë* e paradigmës M. Totoni nuk e sheh si veçori të strukturave të njësive frazeologjike foljore. Sipas tij, është e vërtetë se të gjitha format mënyrore, kohore e vetore të një foljeje mund të mos marrin pjesë në realizimin e kuptimit të një njësie frazeologjike foljore, por kjo është po kaq e vërtetë edhe për realizimin e kuptimit të një foljeje në një strukturë të lirë (p.sh. folja *vdës* nuk mund të përdoret në vetën e parë të së tashmes etj.). Njësia frazeologjike është realizim i një strukture të caktuar, përbërësit e së cilës hyjnë në lidhje kuptimore e gramatikore të caktuara. Asnjë ndryshim që prek strukturën, lidhjet e brendshme kuptimore dhe lidhjet kontekstuale nuk mund të bëhen pa cenuar kuptimin frazeologjik. Ngurosja e gjymtyrës në njësitë frazeologjike *bëj fjalë*, *bëj detyrën*, *i bëj varrin*, *marr erë*, *i marr erë*, *i dha udhët* e të tjera të tilla është iluzion që rrjedh nga izolimi i njësisë frazeologjike nga *konteksti* ku realizohet dhe

nga konceptimi i strukturës së tij si togfjalësh<sup>5</sup>.

Me *togfjalësha të qëndrueshëm*, një autor tjetër, M. Samara, ka parasysh ato njësi gjuhësore, që “janë leksikalizuar plotësisht” ose kanë “tendencë leksikalizimi”; këta togfjalësha “janë ekuivalente kuptimisht me një fjalë të vetme; më drejt, sinonime të fjalëve ekzistuese”; “ata nuk formohen në çastin e ligjërit, po janë ndërtuar historikisht, janë bërë të pazbërthueshëm dhe përdoren si njësi të gatshme, njësoj si fjalë”<sup>6</sup>. Shumica e tyre janë frazeologji që përquasen me fjalët e përngjitura, sepse ato nuk formojnë modele (gjedhe) formimi. Në leksikun e ri politiko-shoqëror të shqipes një vend të rëndësishëm zënë njësitë e reja leksikore të formuara analitikisht (d.m.th. të togfjalëshave të qëndrueshëm) brenda shqipes ose si një huazim jo i drejtpërdrejtë, d.m.th. me anë të kalkimit: *rrugë parlamenteare, zonë (sferë) influence, tryezë e rrumbullaktë, tryezë e bisedimeve* etj.<sup>7</sup>.

Në rrjedhën e studimeve tona për strukturën gramatikore e leksikore të shqipes së sotme, edhe për Xhevat Lloshin meritojnë vëmendje parimet karakterizuese, por edhe dalluese, për togfjalëshat e qëndrueshëm dhe ata frazeologjikë. Sipas tij, trajtimi teorik i këtyre çështjeve ka sjellë vënien në qarkullim të një materiali të pasur faktik për frazeologjinë shqipe dhe përgjithësisht për togfjalëshat e qëndrueshëm, duke i mbështetur përfundimet jo në shembuj të ndërtuar, por të nxjerrë nga një kërkim i kujdesshëm në letërsinë artistike dhe në literaturën tjetër, nga folklori e nga gjuha e gjallë e folur popullore. Për Xh. Lloshin njësia frazeologjike shihet si tërësi e vetme kompakte dhe kriteret formale janë në funksion të saj; thelbi i njësive frazeologjike është parë te qëndrueshmëria e tyre, e cila është e lidhur ngushtë me konceptin e togut barasvlerës me një fjalë të vetme. Qëndrueshmëria mbetet tipari kryesor i njësive frazeologjike, porse, ndryshe nga togfjalëshat e tjerë, këtu ajo del para së gjithash e mbi të gjitha si qëndrueshmëri semantike, ndërsa qëndrueshmëria e formës si e varur prej saj. Ai mendon se togfjalëshat frazeologjikë janë ekuivalentë jo me një fjalë, por me një kuptim të fjalës, dhe jo me çfarëdo kuptimi, por me një kuptim të derivuar e të figurshëm. Ai, gjithashtu, kundërshton idenë e J. Thomait, i cili mendon që në frazeologjinë e gjuhës të përfshihen edhe ato

<sup>5</sup> M. Totoni, *A është togfjalësh struktura e një frazeologjizmi foljor?*, në SF, 1994, 1-4; resp. f. 175, 179-180.

<sup>6</sup> M. Samara, *Antonimia e togfjalëshave të qëndrueshëm në gjuhën e sotme shqipe*, në SF, 1981, 4, f. 45.

<sup>7</sup> M. Samara, *Mbi leksikun politiko-shoqëror të shqipes dhe mbi zhvillimin e tij pas çlirimit*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, I, f. 278-279.

bashkime të qëndrueshme fjalësh, që kanë karakter emërtues, d.m.th. që shprehin koncepte. Sipas Xh. Lloshit, togfjalëshat ekuivalentë me një fjalë në kuptimin e drejtpërdrejtë mbeten jashtë frazeologjisë, krahas çdo togu ku ka gjymtyrë që përdoren me kuptim të drejtpërdrejtë, sepse togjet frazeologjike lindin jo për të shprehur koncepte, por thjesht për të emërtuar sendet, fenomenet e marrëdhëniet. Ai vëren se ka rëndësi të ritheksohet nevoja e studimit të strukturës kuptimore të fjalës për të veçuar togjet e qëndrueshme e ato frazeologjike, nevoja e një *ballafaqimi të vazhdueshëm të frazeologjisë me këtë strukturë*<sup>8</sup>.

Sipas A. Kostallarit, ndër të parët studiues që është marrë me termat e përcaktimit semantiko-konceptor të tyre, “me *frazeologji*, në *vështrimin më të gjerë gjuhësor*, kuptojmë të gjitha ato bashkëlidhje (togje) fjalësh me kuptim tërësor dhe me përbërje e strukturë të qëndrueshme, ku ose të gjitha pjesët (gjymtyrët), ose qoftë edhe vetëm një pjesë (gjymtyrë) përdoret në kuptim *jo të lirë*. Këto bashkëlidhje funksionojnë në gjuhë si ndërtime të mëvetësishme, që nuk formohen aty për aty lirisht në procesin e të folurit, por riprodhohen si *njësi të gatshme* të sistemit gjuhësor. Kjo i bën ato semantikisht e sintaktikisht të ngjashme me fjalën dhe i dallon nga lidhjet e lira të fjalëve”<sup>9</sup>. Pak a shumë në të njëjtën mënyrë shprehet, përveç të tjerësh, edhe Shefkije Islamaj, kur pohon se njësitë frazeologjike janë bashkime të qëndrueshme fjalësh, të formuara historikisht dhe të kristalizuara si njësi kompakte, që nga ana e kuptimit kategorial janë ekuivalente me fjalët. Tipari më thelbësor i tyre është njësia kuptimore. Pra, ato janë ekuivalente të fjalës<sup>10</sup>.

Sipas A. Kostallarit, parimi themelor i dallimit të këtyre bashkëlidhjeve gjuhësore të qëndrueshme ose njësive frazeologjike është parimi semantiko-funksional, d.m.th. kuptimi leksikor i tyre, si njësi me funksione nominative dhe, në lidhje me këtë, funksioni sintaktik. Veçoritë e njësive frazeologjike ai i nxjerr edhe nëpërmjet klasifikimit e, sipas tij, dallohen katër grupe kryesore: a) Njësi frazeologjike ekuivalente me fjalët shënuese, që kryejnë në fjali funksione të mëvetësishme (si pjesë a gjymtyrë të fjalisë); b) njësi frazeologjike ekuivalente me fjalët joshënuese (me fjalët shërbyese a ndihmëse), që kryejnë në fjali funksione jo të mëvetësishme

<sup>8</sup> Xh. Lloshi, *Shënime për fjalën dhe togfjalëshin*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, I; resp. f. 439, 149, 152.

<sup>9</sup> A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, II, f. 32.

<sup>10</sup> Sh. Islamaj, *Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe*, në SF, 1986, 4, f. 119.

(shërbejnë vetëm si tregues marrëdhëniesh të caktuara midis gjymtyrëve të fjalisë); këtu përfshihen bashkëlidhjet gramatikore që kryejnë funksionin e *parafjalëve* e të *lidhëzave*, si p.sh. *me anën e...*, *duke qenë se...*, *si edhe, po qe se, përsa i përket* etj.<sup>11</sup>; sipas J. Thomait këto *lokucione gramatikore* (me vlerë lidhëze a parafjale) nuk janë njësi frazeologjike të mirëfillta<sup>12</sup>; c) njësi frazeologjike modale, ku hyjnë ndërtimet frazeologjike modale, që nuk janë gjymtyrë të fjalisë, por kanë të bëjnë me gjithë fjalinë si elemente që tregojnë raportin e përmbajtjes së fjalisë me realitetin ose shkallën e vërtetësisë së mendimit që shprehet, qëndrimin e folësit ndaj asaj që thotë; të tilla janë, p.sh., *si të thuash, si i thonë, fjala vjen, kuptohet vetvetiu* etj.<sup>13</sup>; J. Thomai i quan këto njësi frazeologjike të *ndërmjetme*<sup>14</sup>; ç) njësi frazeologjike pasthirmore, që qëndrojnë si një grup më vete dhe shprehin drejtpërdrejt ndjenjat e folësit; futja e tyre në frazeologjinë gjuhësore ka po atë karakter konvencional që ka edhe përfshirja e pasthirmave në leksikun e gjuhës; Njësitë frazeologjike pasthirmore janë të tipeve më të ndryshme, p.sh. *punë e madhe!*, *s'ke ç'i thua!*, *më plaçin sytë!*, *mos paça kokën!*, *m'u thaftë gjuha!*, *hej dreq!*, *në djall të vejë!*, *s'ka gjë!*, *s'prish punë!*, *zot na ruaj!*, *lëre mos e nga!*, *që ç'ke me të!*, *bir Selman i nënës!* etj.<sup>15</sup>; edhe J. Thomai i trajton po kështu këto njësi<sup>16</sup>. Njësitë frazeologjike modale e ato pasthirmore të këtij klasifikimi fillestar kanë qenë grupe të diskutueshme, por e përgjithshme ka qenë pranimi i ndërthurjes së kriterëve leksiko-semantike e sintaksore. Është me interes shkencor të krahasohen mendimet e ndryshme dhe të zbulohen mospajtimet në parimet, në kriteret e përgjithshme dhe në cilësimin e njësive konkrete sipas tipologjisë strukturore e semantike. Prandaj e shohim të nevojshme përimtimin e mëtejshëm brenda çdo klase, grupi a tipi frazeologjik. Kështu, në njësitë frazeologjike gjuhësore të tipit të parë, A. Kostallari përfshin: a) *përngjitjet frazeologjike*, b) *njësitë frazeologjike*, c) *bashkëlidhjet ose bashkimet frazeologjike*, ç) *emërtimet e pathjeshta e termat e pathjeshtë*, d) *bashkëlidhjet e qëndrueshme gramatikore me vlerë ndajfoljore*<sup>17</sup>. Këtu e më tutje duket një pranim i klasifikimit të njësive frazeologjike nën ndikimin e letërsisë gju-

<sup>11</sup> A. Kostallari, *Parimet ...*, f. 38-40.

<sup>12</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, Botimet Toena, 2006, f. 235; disa nga çështjet që trajtohen në këtë punim J. Thomai i ka trajtuar, me interpretim teorik, edhe te *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, f. IX-LXII.

<sup>13</sup> A. Kostallari, *Parimet...*, f. 40.

<sup>14</sup> J. Thomai, *Leksikologjia...*, f. 234.

<sup>15</sup> A. Kostallari, *Parimet...*, f. 40.

<sup>16</sup> J. Thomai, *Leksikologjia...*, f. 234.

<sup>17</sup> A. Kostallari, *Parimet...*, f. 38-40.

hësore ruse, përfshirë edhe termin *frazeologjizëm*.

Për *përngjitjet frazeologjike* njihet një shkallë më e lartë e bashkëlidhjes midis gjymtyrëve përbërëse dhe e karakterit idiomatik. Përbërësit e këtyre përngjitjeve, në përgjithësi, lidhen shumë ngushtë e shkrihen në një njësi semantike, kuptimi i veçantë i secilit përbërës nuk kushtëzon kuptimin e gjithë njësisë frazeologjike. Të tilla janë përngjitjet frazeologjike me gjymtyrë arkaike të pamotivueshme ose me kuptim e përdorim sot të errësuar (*bëj pallë, vë re, i jap dum, më ra bretku, me laçkë e me plaçkë, me tasha e kotesha, me cull e mull...*); po ashtu disa togfjalësha të qëndrueshëm frazeologjikë me burim nga ngjarje e fakte historike e jetësore, nga mitologjia, nga episodet biblike etj.; p.sh. *si frëngu pulën, dushk për gogla, mban avazin e Mukës, si në kohën e Babaqemos, për mustaqet e Çelos, iu bë ferra Brahim, si Xhaferrit simiten, ndërroi jetë, e ndjeu Perëndia* etj.; hyjnë edhe togfjalëshat e qëndrueshëm frazeologjikë, të cilët kanë vetëm një kuptim të mundshëm, – kuptimin e figurshëm frazeologjik, si: *i bëj ballë, u bë derr, mbledh mendjen, s'ma ha syri, shes mend, lëshoj gojën, m'u bë koka daulle* etj.

Për *njësitë frazeologjike*, d.m.th., togfjalëshat frazeologjikë me kuptim tërësor të figurshëm, pranohet që kuptimi fillestar i përbërësve nuk është shuar dhe duket pak a shumë qartë në përdorimin e tyre. Këtyre togjeve frazeologjike, të cilat deri-diku janë të motivueshme, u përgjigjen në gjuhën e sotme togfjalësha të lirë me kuptim të drejtpërdrejtë, jo të figurshëm, të cilët të kujtojnë burimin e tyre, si: *ka dorë, ngul këmbë, hap sytë, e pres me këmbët e para* e shumë të tjera. Edhe J. Thomai këto njësi i trajton si të motivueshme<sup>18</sup>. Ndërkaq, A. Kostallari thekson se kufijtë midis njësisve frazeologjike të këtyre tipeve, të cilat mund të bashkohen edhe në një grup të vetëm si idioma ose shprehje idiomatike, nuk janë kurdoherë të qartë e të prerë. Ndryshimi i kushteve historiko-shoqërore e jetësore sjell si pasojë që njësitë frazeologjike mund të shndërrohen në përngjitje.

Për *bashkëlidhjet ose bashkimet frazeologjike*, me *njërin komponent në kuptim jo të lirë (të lidhur)*, pranohet që kuptimi i së tërës u përgjigjet kuptimeve të fjalëve përbërëse, pra, nga pikëpamja semantike janë plotësisht të zërthyeshme. Zakonisht këto bashkëlidhje përbëhen nga një folje me kuptim të figurshëm dhe nga një emër me kuptim të drejtpërdrejtë; p.sh. *bëj durim, bëj shaka, zë besë, i dal zot, i jap fjalën, marr vendim, merr flakë, ka peshë, jap urdhër, kam shpresë, më merr malli, mori erë* etj.. Sipas J. Thomait, edhe më të motivueshme janë ato njësi që ndërtohen nga një gjymtyrë me kuptim të figurshëm (zakonisht folje) dhe një gjymtyrë

<sup>18</sup> J. Thomai, *Leksikologjia...*, f. 224.

me kuptim të drejtpërdrejtë (zakonisht emër).<sup>19</sup> Grupi i njësive të tilla qëndron shumë afër me togfjalëshat e lirë, është, si të thuash, shkalla e kalimit prej këtyre në togfjalësha frazeologjike. Madje, ai pohon se ka studiues që këtë grup nuk e përfshijnë në frazeologji. Sidoqoftë, edhe ky grup duhet parë me kujdes, sepse përbëhet nga një varg i gjatë *togfjalëshash të qëndrueshëm*, me gjymtyrë të lidhura ngushtë dhe që japin një kuptim të vetëm, tërësor<sup>20</sup>. Siç shihet, është me rëndësi që përdoren këtu dy tregues semantikë, joformalë: figurshmëria (te njëra gjymtyrë) dhe motivimi (për gjithë togfjalëshin).

Për *emërtimet e pathjeshta e termat e pathjeshtë*, të cilët kanë sot një përhapje shumë të gjerë në gjuhën e shkruar e të folur, vihet re që njëri nga përbërësit strukturorë e ka humbur kuptimin e vet kryesor dhe, në tërësi, emërtimi është rikuptimësuar; ky tipar i afron këto emërtime deri diku me idiomat. Të tilla janë, p.sh., *zorra e verbër, bar miu, lule sapuni, gjel deti, kolla e mirë (e bardhë), kali i qyqes, Kashta e Kumtrit, thundër mushke, fik deti*<sup>21</sup> e shumë të tjera. Këta *terma të pathjeshtë* të fushës së bimësisë, të gjeografisë, të historisë etj., që ndërtohen me emra e mbiemra dhe që përdoren në mënyrë të figurshme, J. Thomai i trajton si njësi që kanë kuptimin kategorial të emrit: *bisht lepuri, gjuhë lope, gjurmë mushke, mollë dheu...* (emërtime bimësh); *lakuriqi i natës, musja e lalës...* (emërtime kafshësh e shpendësh); *Byku i Kumbarës, Qerrja e Madhe, Udha e Qumështit...* (emërtime yllësish) ...<sup>22</sup> etj. Me këtë zgjidhje është pranuar që në sistemet terminologjike shqipe përfshihen edhe njësi frazeologjike, si lëndë e grupit të togfjalëshave të qëndrueshëm terminologjike.

Cilësim të një grupi të veçantë kanë pasur në studimet frazeologjike shqiptare të ashtuquajturat *bashkëlidhje të qëndrueshme gramatikore me vlerë ndajfoljore* të dy tipeve strukturorë: të formuara zakonisht nga një fjalë joshënuese (ndihmëse) dhe nga një fjalë shënuese dhe të formuara nga përsëritja jo e pandërmjetme e së njëjtës fjalë shënuese në këtë ose atë trajtë të saj. Në tipin e parë strukturor përfshihen *bashkëlidhjet gramatikore të figurshme*, si: *nën dorë, me një frymë, prapa krahëve, për bukuri, prapa diellit, në tym, para syve*<sup>23</sup> etj. J. Thomai i trajton këto njësi si “lokucione” dhe, sipas tij, ato nuk mund të përfshihen në frazeologjinë e mirëfilltë gjuhësore, sepse nuk kanë strukturën e togfjalëshave, në kuptimin

<sup>19</sup> A. Kostallari, *Parimet...*, f. 39.

<sup>20</sup> J. Thomai, *Leksikologjia...*, f. 226.

<sup>21</sup> A. Kostallari, *Parimet...*, f. 39.

<sup>22</sup> J. Thomai, *Leksikologjia...*, f. 228.

<sup>23</sup> A. Kostallari, *Parimet...*, f. 39.

tradicional, pavarësisht se janë përdorur me kuptim të figurshëm<sup>24</sup>. Në tipin e dytë strukturor përfshihen njësitë frazeologjike ndajfoljore me ose pa kuptim të figurshëm, si : *anës e anës, sy për sy, ballë për ballë, kohë pas kohe, herë pas here, ditë për ditë, orë e çast, një nga një, pak nga pak, tani për tani* etj. Janë togfjalësha me përtsëritje të së njëjtës fjalë a prej dy fjalësh me lidhje paradigmatiche. Siç shihet, autorët i afrohen këtu edhe më shumë gramatikës dhe gjejnë atje njësi të saja me tipare të pjeshme frazeologjike.

Lidhur me klasifikimin a grupimin leksiko-gramatikor frazeologët shqiptarë kanë thujse të njëjtat kritere dhe të njëjtat modele. Duke u nisur nga karakteristikat leksiko-gramatikore, nga vlera e tyre ekuivalente me këtë ose atë pjesë të ligjëratës, A. Kostallari i ndan ndërtimet frazeologjike në këto kategori tipologjike kryesore:<sup>25</sup> – Njësi frazeologjike *emërore*: *viç i palëpirë* (edhe si *mb.*), *daulle e çpuar* (edhe si *mb.*), *gur prove, gur themeli, qiçra në hell, ëndrra me sy hapur (në diell), të zitë e ullirit, punë pa bulmet, pemë pa kokrra* (edhe si *mb.*), *mëngë në mes të kurrizit, lojë fjalësh, stan me lepuj, këmbëza e urës* etj.; ky tip shpjegohet në fjalorë njëloj si fjalët-emra. – Njësi frazeologjike *foljore*: *vë dorë, var buzët, var kokën, e sjell vërdallë, e bëj veshin të shurdhër, i hedh hi syve, i bie legenit, fus hundët, hedh baltë, i kreh bishtin, ua mbathi këmbëve, i vë fshesën, u bë pulë* etj.; këto njësi frazeologjike, të cilat mund të jenë të ndërtuara edhe si fjali, zakonisht dygjymtyrëshe, luajnë rolin e kallëzuesit dhe shpjegohen njësoj si fjalët-folje. – Njësi frazeologjike *mbiemërore*: *s'ia ha qeni shkopin, s'është kushedi se çë, e ha hekurin me dhëmbë, i pret gjuha brisk, ta merr (ta rrëmben) fjalën nga goja, t'i marrësh kokën* “shumë e bukur”, *kockë e lëkurë, i hurit e i litarit, me lugë në brez, si pulë e lagur, bukë e djathë* “i lehtë, jo i vështirë” etj.; po shtojmë që këto njësi frazeologjike, në një pjesë të madhe, janë me strukturë fjalie, sepse përmbajnë një përbërës foljor, çka ndikon edhe në gjymtyrësinë e tyre, pra, mund të kenë më shumë se dy gjymtyrë, kanë ngjyrim të qartë shprehës-emocionues dhe shpjegohen në fjalorë si fjalët-mbiemra. – Një grup të pasur e të larmishëm nga struktura përbëjnë njësitë frazeologjike *ndajfoljore*: *një herë e një kohë, kokë e këmbë, gjer në palcë, si kripa në ujë, si kofini pas të vjelit, me tesha e kotesha* “me çdo gjë që ka”, *si macja me minë, brez pas brezi, lesh e li, me gisht në gojë, pa një pa dy, si këmbët e dhisë* “njësoj”, *nga sytë këmbët* etj.; këto njësi frazeologjike shpjegohen si fjalët-ndajfolje. A. Kostallari pranon edhe një grup njësisish frazeologjike *pasthirrmore*: *punë e*

<sup>24</sup> J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981, f. 127.

<sup>25</sup> A. Kostallari, *Parimet...*, resp. f. 40, 43-44.

*madhe!, hej dreq!, qoftë larg!, sa para bën!* etj., të cilat shpjegohen sikurse tipet e ndryshme të fjalëve-pasthirrma. Por ai pranon si grup më vete *njësish frazeologjike*, siç u tha, edhe disa ndërtime, që kanë vlerë thjesht gramatikore (lidhëza, parafjalë) ose modale (fjalë të ndërmjetme), që në fjalorë shpjegohen sipas tipit të fjalëve joshënuese ose modale përkatëse. Veçanërisht këto të fundit janë vënë në pikëpyetje prej autorësh të tjerë ose nuk janë pranuar si njësi të kategorisë frazeologjike.

Frytdhënës është trajtimi i njësive frazeologjike në aspektin sintaksor. M. Totoni hedh mjaft ide interesante në lidhje me strukturën togfjalëshore të njësive frazeologjike. Studimi i tij lidhet kryesisht me njësi frazeologjike foljore, përcaktimi gramatikor i strukturës së të cilave është një çështje, jo vetëm me rëndësi teorike, por edhe praktike. Drejt këtij trajtimi atë, si sintaksolog e studiues i njësisë kryesore sintaksore, e tërheq bërthama e fjalisë, togfjalëshi *kryefjalë – kallëzues*, që, siç dihet, ka autorë që nuk e përfshijnë në kategorinë e togfjalëshave sipas konceptit tradicional. Në studimet për njësitë frazeologjike të gjuhës shqipe pohohet se strukturat frazeologjike janë ngurosur në shkallë të ndryshme. Në qoftë se për një frazeolog kjo është e mjaftueshme, për një sintaksolog kjo është shtysë për përcaktimin e përkatësisë kategoriale të strukturave të ngurtësuara: A kemi një strukturë sintaksore apo tashmë është formuar si njësi e një rrafshi tjetër, e morfologjisë? Struktura e njësive frazeologjike foljore është togfjalëshore apo e tipit fjali e aktualizuar (ose një pjesë e saj)? A duhet trajtuar si një gjymtyrë fjalie struktura e njësive frazeologjike foljore apo duhet gjymtyrëzuar si çdo strukturë e lirë? Ç’rëndësi ka kjo për studimet frazeologjike në rrafshin leksikologjik dhe për praktikën gjuhësore? Zgjidhja e drejtë e këtyre çështjeve në rrafshin gramatikor i sheston rrugën frazeologut dhe e shtyn atë të merret me të shënuarin, që është objekt i vërtetë i teorisë frazeologjike<sup>26</sup>.

Trajtimi i “shprehjeve foljore” si një *gjymtyrë fjalie* është më i hershëm në sintaksat e shqipes. Ky trajtim del që në sintaksën e Aleksandër Xhuvanit, por te sintaksa e Mahir Domit gjen një shtjellim më të plotë e më të argumentuar. Ai shkruan: “Si kallëzues foljor mund të kemi edhe shprehje foljore të formuara prej një folje dhe prej një emri të shoqëruar ose jo me parafjalë. Në këto raste ky grup fjalësh formon një kuptim të vetëm, ka vlerën e një foljeje të vetme dhe mund të marrë edhe kundrinë të drejtë a të zhdrejtë. Të tilla janë shprehjet: *mbaj mend, kam frikë, ngul këmbë, i zë besë, e qis në krye* (~ një punë), *i bëj ballë, vë gojë, vë vesh, vë*

<sup>26</sup> M. Totoni, *A është togfjalësh...*, f. 175.

*dorë* etj.”<sup>27</sup>. Siç shihet, dy janë kushtet që një shprehje foljore të funksionojë si kallëzues: të ketë një kuptim tërësor, sinonimik me kuptimin e një foljeje, dhe të jetë errësuar lidhja ndërmjet përbërësve të shprehjes. Nëse mbahen parasysh këto kritere, si dhe materiali ilustrues që jepet, mund të thuhet që këtu “shprehja” shihet në rrafshin *morfologjik*, si pjesë e ligjëratës. Por në gramatikat e shqipes nuk ka pasur një koncept a shpjegim të qartë për shprehjen (lokucionin a perifrazën) dhe për takimin e ndarjen me njësinë frazeologjike. Termat *shprehje*, *lokucion* a *perifrazë* janë përdorur edhe për struktura frazeologjike që nuk ngjajnë të jenë lokucione<sup>28</sup>. Togfjalëshi, si një tërësi mund të funksionojë si gjymtyrë fjalie dhe këtu zbulohet, ndër të tjera, rëndësia e madhe që ka ai për strukturën e fjalisë<sup>29</sup>.

Duke iu referuar M. Çelikut, M. Ttoni thotë se, “ndonëse analiza e materialit është bërë me terminologji sintaksore, gjë që parakupton, para së gjithash, analizën e strukturës, M. Çeliku përqendrohet në shpjegimin e kuptimit tërësor të togfjalëshit, pas të cilit sheh humbje të lidhjeve e të marrëdhënieve dhe ngurosje të përbërësit të dytë, për këtë arsye mendon që në analizën e fjalisë këta lloj togfjalëshash duhet të merren si një gjymtyrë fjalie”. M. Ttoni vëren gjithashtu se M. Çeliku ka një koncept tepër të gjerë e të papërcaktuar për togfjalëshin, pasi përfshin në këtë kategori edhe dy folje që bashkërenditen (*za* e *ha*), dy folje që bashkohen me lidhje nënrenditëse (*duhet të shkoj*, *mund të vij*), si dhe ndërtime me strukturë fjalie (*e futi në dhe*, *të mos e bëjmë të gjatë*, *e pret ngordhja* etj.)<sup>30</sup>.

Duke ndjekur traditën gramatikore, Zana Karapici i studion shprehjet foljore si njësi të rrafshit *morfologjik*. Shprehja edhe për atë studiuese është një “ndërtim gramatikor me strukturë togfjalëshi, ku pjesët përbërëse si kuptimisht, ashtu edhe gramatikisht, formojnë një njësi të pandashme me vlerë foljore”. Si tipare karakteristike të një shprehjeje autorja quan zbehjen e kuptimit leksikor të përbërësve, humbjen e lidhjeve sintaksore midis përbërësve dhe ngurosjen e përbërësit të dytë. Sipas M. Ttonit, ky përcaktim i shprehjes foljore dhe tiparet që e karakterizojnë janë dhënë drejt, por në analizën e materialit këto nuk janë marrë gjithnjë parasysh e nuk është vënë kufiri midis shprehjes foljore dhe njësisë frazeologjike, nga njëra anë, dhe midis këtyre e togfjalëshit të lirë, nga ana tjetër. Te *kam shpresë*, që jepet si shprehje, mund të identifikohet një kuptim tërësor “shpresoj”, por asnjë nga tiparet e mësipërme nuk vërtetohet, as kuptimi

<sup>27</sup> M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe*. Pjesa e dytë. *Sintaksa*, Tiranë, 1957, f. 28.

<sup>28</sup> M. Ttoni, *A është togfjalësh...*, f. 175.

<sup>29</sup> S. Floqi, *Çështje të ...*, f. 191.

<sup>30</sup> M. Ttoni, *A është togfjalësh...*, f. 176.

leksikor dhe as lidhja nuk janë zbehur. Tek *e humbi fillin*, në frazën *Pastaj heshtje dhe prapë e humbi fillin*<sup>31</sup>, gjithashtu, nuk ka zbehje të kuptimit të përbërësve dhe as humbje të lidhjes midis tyre; kuptimi tërësor “u hutua” është rezultat i kalimit të figurshëm të të gjithë togut. Po sipas M. Totonit, këto raste e të gjitha të tjerat të ngjashme me to, nuk duhej të trajtoheshin si shprehje, por, siç duket, edhe këtu absolutizohet barasvlershmëria me kuptimin e një foljeje<sup>32</sup>. Ajo që e vlen të theksohet këtu është që tipare frazeologjike mund të ketë në shumë struktura edhe pa qenë ato njësi frazeologjike, sepse ka tipare të tilla që janë të pamjaftueshme për t’i bërë të tilla. Kjo shpreh edhe lëvizshmërinë e kufijve ndërmjet frazeologjisë gjuhësore dhe disa njësive të sistemit gramatikor (morfologjik e sintaksor).

Me të drejtë M. Totoni nënvizon se barazimi i njësisë frazeologjike me gjymtyrë fjalie nuk mund të jetë frytdhënës për sintaksën, sepse struktura duhet të përcaktohet më përpara nga pikëpamja leksikologjike, pastaj të përcaktohet përkatësia e saj si gjymtyrë fjalie. Veç kësaj, vetë studiuesit e frazeologjisë në gjuhën shqipe tregohen më pak të prerë se sintaksologët, kur pohojnë që si gjymtyrë fjalie funksionojnë ato njësi frazeologjike që kanë karakter të theksuar idiomatik<sup>33</sup>. M. Totoni bashkohet me mendimin e J. Thomait se njësitet frazeologjike kanë shkallë të ndryshme ngurtësimi, si te *vë re* ku kemi idiomatizim të plotë, por ai pohon se nuk mund të themi të njëjtën gjë për njësitet frazeologjike *u shkoi koha, nuk ha bar dhe më erdhi shpirti në majë të hundës*. Togu *u shkoi koha* mund të realizojë kuptime frazeologjike në varësi nga kuptimi i kundrinorit të zhdrejtë. Në qoftë se ai shpreh një objekt-njeri, ka kuptimin “u plakën”: *Baballarëve tanë u shkoi koha, tani na bie barra neve*; në qoftë se shpreh një objekt-pemë, perime, ka kuptimin “s’pëlqehet, s’hahet”: *U shkoi koha kungujve*; në qoftë se shpreh një objekt-veshje ose zbukurim, ka kuptimin “s’është në modë”: *U ka shkuar koha flokëve të gjatë*. Siç shihet, e njëjta strukturë në lidhje *kontekstuale* të ndryshme na jep tri kuptime frazeologjike. Lindja e këtyre kuptimeve nuk kushtëzohet nga lëvizjet kuptimore të fjalëve të veçanta e nga zhdukja e marrëdhënieve dhe e lidhjeve që vendosen midis tyre, po nga lidhja kuptimore me një fjalë tjetër, e cila nuk përfshihet as në strukturën e njësisë frazeologjike. Prej këtij nxjerrim përfundim se integrimi i njësive frazeologjike në struktura sintaksore (në fjali) zbulon vlerat e tyre semantiko-ekspresive, por duhet pranuar që këto vlera nuk “fitohen” në këto struktura; ato janë mundësi “të fshehura” të

<sup>31</sup> Z. Karapici, *Shprehje foljore të tipit folje+emër*, në SF, 1986, 1; resp. f. 126-128, 129.

<sup>32</sup> M. Totoni, *A është togfjalësh...*, f. 176-177.

<sup>33</sup> J. Thomai, *Çështje...*, f. 54.

vetë njësive frazeologjike e në këto kontekste vetëm sendërtohen, në pajtim edhe me situata ligjërimore.

M. Totoni pohon, gjithashtu me të drejtë, se po të mos e shohim njësinë frazeologjike në vetvete, të shkëputur, po në lidhjet e saj *kontekstuale*, pohimi i M. Çelikut se "... të ndash në dy njësi sintaktike të veçanta togfjalëshat e leksikalizuem të tipit frazeologjik don të thotë të kërkosh lidhje sintaktike midis komponentëve që nuk kanë qenë (as nuk janë) aspak të lidhuna sintaktikisht. Kjo analizë do të merrete në konsideratë lidhjen sintaktike të togfjalëshave të lirë që kanë shërbye si modele për krijimin e njësive frazeologjike të dhana", është një përgjithësim me kundërthënie të pakapërcyeshme. Si togfjalësh, njësia frazeologjike është strukturë sintaksore". M. Totoni ngre pyetjen e përlligjshme se ç'mund të jetë një strukturë sintaksore, përbërësit e së cilës "nuk kanë qenë (as nuk janë) aspak të lidhuna sintaktikisht"? Sipas tij, është e zorshme që te *kthej fletën* të shohim një strukturë, por dy togfjalësha: një togfjalësh të lirë, midis përbërësve të të cilit ka lidhje sintaksore, dhe një togfjalësh frazeologjik, midis përbërësve të të cilit nuk ka pasur e nuk ka lidhje sintaksore. Në këtë konceptim nuk bëhet një dallim i qartë i rrafshit leksikologjik nga rrafshi sintaksor. Në rrafshin leksikologjik te ky togfjalësh dallojmë një kuptim të drejtpërdrejtë dhe, po ta mendojmë si pjesë të një *konteksti* të caktuar, mund të dallojmë edhe një kuptim të figurshëm, frazeologjik, që lind mbi të parin. Kalimi në kuptimin e dytë nuk sjell asnjë ndryshim në rrafshin sintaksor, prandaj edhe nuk ka pse të mendohet një strukturë e ndryshme për kuptimin frazeologjik. Po të bëhet një paralelizëm me fjalën, kur fiton një kuptim të figurshëm, atëherë ky pohim bëhet më i qartë. Sipas nesh, meqë në rrafshin leksikor nuk shihet lidhja e brendshme sintaksore e njësisë frazeologjike, nuk do të thotë që kjo njësi është frazeologjizuar pa këto lidhje të brendshme sintaksore.

Sipas M. Totonit, struktura e njësisë frazeologjike foljore nuk është strukturë e abstraktuar, që del nga analiza e fjalisë, por një strukturë e realizuar që karakterizohet nga tregues të fjalisë e të frazës. Ndër ta ai përmend njësi frazeologjike që janë *struktura me lidhje tipike për fjalinë* (*ma thotë mendja, më pjell mendja, më plasi shpirti, më ranë këmbët, më mori dreqi, më ranë pendët, m'u mbështoll lëmshi, iu derdhën trutë, i doli boja, më mbushet syri* etj., ku emri është kryefjalë dhe folja kallëzues, si dhe *bëhem erë / ~ derr / ~ spec / ~ tapë, i bëhem krah / ~ ferrë / ~ rrodhe, e bëj rrugë / ~ hi / ~ çorbë / ~ tërkuzë / ~ peshk / ~ shoshë* etj., ku emri është përcaktor kallëzuesor dhe folja kallëzues); po ashtu njësi frazeologjike që karakterizohen nga prania e trajtave të shkurtra, të cilat tregojnë se struktura e njësisë frazeologjike është e shkëputur nga *konteksti* i caktuar

ose është përdorur në një situatë të caktuar (p.sh. *i hipën kacabujtë* realizon kuptimin “u nxe”, në qoftë se nga konteksti ose nga situata bëhet e qartë që me trajtën e shkurtër nënkuptohet një njeri që ndodhet në një situatë të nderë; pa trajtën e shkurtër dhe jashtë konteksti, ky ndërtim nuk është njësi frazeologjike: *hipën kacabujtë* dhe *i hipën kacabujtë në kurriz*; njësia frazeologjike *ia nxjerr me grep* nënkupton një situatë që të bëjë të qartë se trajta e shkurtër e kallëzores zëvendëson emrin *fjalë* ose *përgjigje*, ndryshe s’mund të jetë e tillë; po kështu, ndërtimi *e bëj për vete* është njësi frazeologjike, në qoftë se trajta e shkurtër zëvendëson emra, si: *mik, shok, vëlla, pra, e bëri për vete shokun*, por nuk është e tillë, në qoftë se zëvendëson emra sendesh: *e bëri për vete / ~ për mua / ~ për ty këtë pikturë*; më tej, autori njeh grupin e njësive frazeologjike që kanë strukturë mohuese (p.sh. *nuk ha bar, nuk ha pykë, nuk ia ha qeni shkopin* etj., gjë që tregon qartë se kemi të bëjmë jo me strukturë togfjalëshi, po me strukturë fjalie) dhe së fundi njësi frazeologjike foljore, që karakterizohen nga një intonacion e rend i caktuar të përbërësve, çka tregon, gjithashtu, se kjo strukturë është organizuar si frazë.

Diskutimi në është struktura e njësisë frazeologjike foljore togfjalësh apo frazë a pjesë e një fraze, sipas M. Totonit, i intereson kryesisht sintaksës, por ai nuk është pa vlerë edhe për teorinë e frazeologjisë. Reduktimi i këtij problemi në trajtimin e strukturës së njësisë frazeologjike foljore si një gjymtyrë fjalie a në gjymtyrëzimin e saj është një thjeshtim deri në formalizëm. Në praktikën gjuhësore, trajtimi i strukturave të njësive frazeologjike foljore si fraza lejon që përtej lidhjeve sipërfaqësore të zbulohen lidhjet e brendshme, që krijohen si rezultat i lindjes së kuptimit frazeologjik, pra, nga kjo strukturë sipërfaqësore të kalohet në strukturën e thellë. Kjo mund të konkretizohet me një shembull: Djalit *i shkoi mendja* te pyjet e lëndinat // Djali *mendoi* për pyjet e lëndinat. Nga shndërrimi del që kundrinori i zhdrejtë në fjalinë e parë është subjekt i kuptimit frazeologjik, kurse rrethanorët janë objekte të tij. Ky shndërrim ndihmon për zbulimin e përmbajtjes së fjalisë. Për M. Totonin kjo është shumë e rëndësishme për analizën sintaksore. Po sipas tij, pohimi se çdo “togfjalësh frazeologjik” është i qëndrueshëm nuk është i saktë<sup>34</sup>. Të mos harrojmë se ai u referohet vetëm njësive frazeologjike foljore dhe ky përgjithësim nuk mund të jetë i drejtë për të gjitha llojet e togfjalëshave frazeologjike. Togfjalëshi i qëndrueshëm duhet parë në rrafshin sintaksor dhe duhet përcaktuar si strukturë e ngurosur sintaksore në kundërvënie me togfjalëshin e lirë. I parë në këtë kundërvënie, togfjalëshi i qëndrueshëm foljor është ai bashkim

<sup>34</sup> M. Totonit, *A është togfjalësh...*, resp. f. 181, 183.

fjalësh, ndërmjet përbërësve të të cilit nuk ka lidhje e marrëdhënie të gjalla, ose ai bashkim fjalësh që përmban një element arkaik, prandaj duhet të përfshihen këtu të gjitha lokucionet foljore, përbërësit e të cilave janë bashkuar sipas rregullsive të shqipes së sotme, por lidhja nuk bëhet e qartë për shkak të kuptimit leksikor a gramatikor të përbërësve. Do të përfshiheshin edhe ato struktura që nuk shpjegohen me rregullsitë e shqipes së sotme, po me rregullsitë e fazave më të hershme të saj, prandaj dhe janë objekt i gramatikës (i sintaksës) historike. Në strukturat *luaj (dal) menç* dhe *dal borxhit* përdorimi i rrjedhore për të shprehur largim nga një send është arkaik në shqipen e sotme; po kështu, përdorimi i parafjalëve *më, në* me një emër në rrjedhore: *marr më sysh, vjen ndoresh* (< në doresh), i parafjalëve *në (më)* e *për* në strukturat *ngop në (më) dru* dhe *i del për hundësh* për të shprehur e para mjetin dhe e dyta vendin nga del diçka, është gjithashtu arkaik. Për shkak të dokumentimit të vonë, struktura të tilla në gjuhën shqipe janë të pakta. Këto që u përmendën, mbijetojnë në gjuhën letrare, shpesh krahas ndërtimeve të lira: *luaj nga mendtë, dal nga borxhi, del nga hundët* (me po ato kuptime) në saje të kuptimit frazeologjik. M. Totoni pranon se struktura frazeologjike nuk përputhet gjithnjë me strukturën e togfjalëshit të qëndrueshëm foljor. Ai krahason strukturat e mësipërme me strukturat frazeologjike: *i dal borxhit, e marr më sysh, më vjen ndoresh, më del për hundësh, e ngop në (më) dru* (për realizimin e kuptimit frazeologjik është e domosdoshme trajta e shkurtër). Togfjalëshat e qëndrueshëm të grupit të dytë nuk e kanë të gjithë të njëjtën shkallë ngurtësimi. Te *dal (luaj) menç, del për hundësh*, për shkak edhe të përqasjes me togfjalëshat e lirë përkatës, mund të dallohet një farë marrëdhënieje, ndërsa te togfjalëshi *marr më sysh*, jo. Në togfjalëshin *vjen ndoresh* humbja e kuptimit sintaksor ka çuar deri në përngjitjen e parafjalës me emrin në rrjedhore dhe në humbjen e kuptimit leksikor të emrit *dorë*, kështu që sot ky tog interpretohet si lokucion (përbërësi i dytë i këtij lokucioni *ndoresh* nuk ka fituar ndonjë kuptim të ri; haset vetëm në lidhje me foljen *vij*, por nuk hyn në marrëdhënie sintaksore me të, prandaj edhe trajtimi i tij si pjesë e ligjëratës, si ndajfolje, nuk mund të qëndrojë). Me gjithë dallimet që vërehen në shkallën e ngurtësimit, të cilat mund të quhen të parëndësishme, tërësia kuptimore dhe kufizimet formale i bëjnë këta togfjalësha të pagjymtyrëzueshëm në shqipen e sotme<sup>35</sup>.

Agron Duro, duke i parë togfjalëshat frazeologjikë në dritën e funksionalizimit si terma, pra, si njësi të fushës së terminologjisë, shprehet se ndër togfjalëshat e qëndrueshëm në letërsinë tonë gjuhësore, në mënyrë më

<sup>35</sup> M. Totoni, *A është togfjalësh...*, f. 185-186.

të hollësishme janë studiuar togfjalëshat frazeologjikë e prej kohësh janë dalluar si kategori të veçanta në sistemin e leksikut si njësi emërtuese jo vetëm togfjalëshat frazeologjikë, por edhe togfjalësha të tjerë të qëndrueshëm (jofrazeologjikë), kryesisht të tipit emëror<sup>36</sup>. Si tipar specifik kryesor, që dallon togfjalëshat e qëndrueshëm jofrazeologjikë me vlerë emërore nga togfjalëshat emërorë të tipit frazeologjik, vendoset karakteri idiomatik e i figurshëm i këtyre të fundit, si dhe kufizimi i tyre gramatikor. Togfjalëshat e qëndrueshëm jofrazeologjikë të tipit *këpucë me qafa, bibliotekë kombëtare* përfshihen në grupin e togfjalëshave të qëndrueshëm jofrazeologjikë të gjuhës së përgjithshme (sikundër *qafë mali, tel me gjemba, shkëmb guri* etj.), kurse *bombë dore* bën pjesë në grupin e togfjalëshave terminologjikë (sikundër *granatë dore, vesh plugu, kokë blloku, emër i përveçëm...*). Të afërt me togfjalëshat terminologjikë nga pikëpamja strukturore e funksionale janë edhe togfjalëshat e qëndrueshëm të gjuhës së përgjithshme tek të cilët, njësoj si tek togfjalëshat terminologjikë, zbulohen mundësitë emërtuese (shënuese) dhe aftësitë kombinuere të elementeve përbërëse të tyre. Sikurse togfjalëshi terminologjik, edhe togfjalëshi i gjuhës së përgjithshme përbën një njësi leksiko-nocionore ose leksiko-sendore brenda një sistemi të një fushe të caktuar, mendon Nexhip Mërkuri<sup>37</sup>.

A. Duro, gjithashtu, thekson se togfjalëshat e qëndrueshëm (jofrazeologjikë) nuk janë vlerësuar më parë sa duhet si një pasuri e veçantë leksikore, që plotëson nevojat e komunikimit nëpërmjet njerëzve njësoj sikurse fjalët. Ashtu si edhe togfjalëshat e lirë, togfjalëshat e qëndrueshëm (jofrazeologjikë) pasqyrojnë, nëpërmjet koncepteve që shprehin, lidhjet ndërmjet objekteve të realitetit objektiv ose të objekteve e të vetive të tyre. Por, në togfjalëshat e qëndrueshëm këto lidhje janë të ngulitura e të përherëshme. Kjo qëndrueshmëri e togfjalëshit e ka bazën në ngulitjen e lidhjeve ndërmjet vetë objekteve ose ndërmjet objekteve e vetive të tyre, të cilat pasqyrohen në togfjalësh<sup>38</sup>. Ndryshe nga togfjalëshi i qëndrueshëm i gjuhës së përgjithshme, togfjalëshi i qëndrueshëm terminologjik përbën një njësi gjuhësoro-konceptore ose logjike-sendore brenda një sistemi të një fushe të caktuar terminologjike. Nga pikëpamja e ndërtimit të vet semantiko-strukturor termi togfjalësh qëndron ndërmjet togfjalëshit të lirë dhe atij frazeologjik.

Si përfundim mund të themi se, me pikëpamjet, këndvështrimet a

<sup>36</sup> A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, QSA, "Fan Noli", 2009, f. 149.

<sup>37</sup> N. Mërkuri, *Emërtime popullore togfjalëshore të bimësisë*, në SF, 1995, 1-4, f. 94.

<sup>38</sup> A. Duro, *Termi dhe fjala...*, resp. f. 150, 153.

qasjet e shumta nga studiues të ndryshëm tashmë janë hedhur bazat teorike rreth kategorisë së togfjalëshave të qëndrueshëm në gjuhën shqipe, çështje e diskutuar gjerë e përsëri e diskutueshme. Edhe vetë koncepti për frazeologjinë herë është më i gjerë dhe herë më i ngushtë. Megjithatë, në përpjekje për të përcaktuar sa më qartë e bindshëm kufijtë e frazeologjisë, po rikujtojmë disa parime tashmë të pranuar si prirje nga gjuhëtarët tanë, që mund të nxirren nga idetë e tyre: frazeologjia po shihet si një degë më vete e gjuhësisë dhe jo si pjesë e leksikologjisë; frazeologjia merret me një nënsistem të gjuhës dhe jo me njësi frazeologjike të izoluar; frazeologjia merret me të gjitha llojet e togfjalëshave të qëndrueshëm; nga togfjalëshat a shprehjet e qëndrueshme dallohen më qartë disa klasa (idioma: *bëj pallë, i jap dum*; njësi frazeologjike a frazeomatike, ose bashkëlidhje të qëndrueshme: *bëj durim, jap urdhër*; midis tyre gjenden rastet e ndërmjetme); dallimi kryesor midis klasave është semantik: idiomat frazeologjike kanë kuptime plotësisht ose pjesërisht të pamotivueshme, kurse përbërësit e njësive frazeologjike a frazeomatike përdoren edhe me kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë; njësitë frazeologjike e frazeomatike trajtohen të lidhura gjithashtu me fjalën, por janë togfjalësha të qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria e tyre frazeologjike i dallon nga togfjalëshat e lirë ose nga fjalët e përbëra; ato përbëhen nga fjalë të ndryshme, statusi i të cilave varet nga lloji i togfjalëshit (a i shprehjes) të qëndrueshëm ku janë përdorur; ndarja e tyre strukturore, si një faktor i rëndësishëm i qëndrueshmërisë, i dallon nga fjalët e përbëra; aspekte të tjera të qëndrueshmërisë së tyre janë: qëndrueshmëria në përdorim, qëndrueshmëria leksikore dhe ajo semantike; qëndrueshmëri në përdorim do të thotë se togfjalëshat e qëndrueshëm riprodhohen si të gatshëm dhe jo të krijuar në çast gjatë ligjërimit; togfjalëshat e qëndrueshëm nuk janë njësi të një stili individual ligjërimit, por njësi gjuhësore të përgjithshme; qëndrueshmëri leksikore do të thotë edhe se fjalët përbërëse të togfjalëshave të qëndrueshëm frazeologjike janë ose të pazëvendësueshme (*vë re*), ose pjesërisht të zëvendësueshme brenda kufijve të ndryshueshmërisë frazeologjike a frazeomatike: leksikore (*pa çarë kryet / ~ kokën*), gramatikore (*si këmbët e dhisë / si këmbët e dhive*), pozicionale (*me dorë në zemër / me zemër në dorë*), sasiore (*bëj çmos / bëj çnuk e çmos*); qëndrueshmëria semantike mbështetet te qëndrueshmëria leksikore e togfjalëshave të qëndrueshëm; edhe kur paraqiten ndryshime të rastësishme, kuptimi i gjithë togfjalëshit ruhet, ai thjesht duhet të specifikohet, të bëhet më i qartë, të dobësohet ose të përforcohet; me fjalë të tjera, pavarësisht nga këto ndryshime, njësitë frazeologjike a frazeomatike, si të dallueshme nga togfjalëshat e lirë, ose mbeten semantikisht të pandryshueshme ose thjesht shpërbëhen.

## ABOUT SUSTAINABLE PHRASES IN ALBANIAN LANGUAGE

### Summary

There have been different theoretical approaches and interpretations about the concept “set phrase” (and expression) in Albanian linguistics. The aim of this paper is to represent some of these theoretical grounds. The study of several types of set phrases (including idioms as well) is important since they refer to a special part of every language under analysis. These units function as words by assigning a unique concept, object or phenomenon and being marked as separate entities. Their study is conceptualized by taking into consideration not only their content as lexical units, but also on their structure and function, as syntactic units. Here are specifically mentioned the contributions of some Albanian scholars Spiro Floqi, Androkli Kostallari, Jani Thomai, Menella Totoni, etc., which are theoretically based on their fields of study, respectively, syntax, word formation, lexicology and semantics.

Significant research on the domain have already established the theoretical ground from both lexical-grammatical and lexical-semantic approaches by identifying common and distinctive features of these units in rapport with other linguistic units. Still, the concept about phraseology sometimes is broader and sometimes not. In trying to define the boundaries of phraseology, we are mentioning some of the main principles, which are more or less accepted as tendencies by our scholars. The following tendencies are itemized from their ideas: phraseology is considered as a separate branch of linguistics and not as part of lexicology; phraseology deals with a subsystem of language and not with isolated phraseological units; phraseology is concerned with all kinds of set phrases; set phrases fall into three main classes (idioms: *bëj pallë, i jap dum*; phraseological and phraseomatic units or collocations: *bëj durim, jap urdhër*; and border-line cases); the main distinction between these classes is semantic: phraseological idioms have fully or partially transferred meanings, while components of phraseomatic units and collocations are used in their literal meanings; phraseological and phraseomatic units are not considered as word-equi-

valents but some of them are treated as word correlates; they are set phrases and their stability distinguishes them from free phrases and compound words; they are made up of words whose status depends on the type of phrase where they are used; their structural separateness, an important factor of their stability, distinguishes them from compound words; others issues of their stability are: stability of use, lexical stability and semantic stability; stability of use means that set phrases are reproduced as ready-made units, they are not elements of individual style of speech; lexical stability means that the components of set phrases are either irreplaceable or partly replaceable within the boundaries of phraseological or phraseomatic variance; semantic stability, on the other hand, is based on the lexical stability of set phrases, even when occasional changes occur the meaning of the the phrase is preserved, it may only be specified, made more precise, weakened or strengthened; in other words, despite of these changes, phraseological and phraseomatic units, as distinguished from free phrases, remain semantically invariant or are destroyed. We have to mention that most of these principles are also influenced by Russian linguistics. All of these ideas contribute to the method of phraseology identification which helps to single out set phrases in Albanian.

but some of them are treated as word compounds, they are set phrases and their stability distinguishes them from free phrases and compound words; they are made up of words whose status depends on the type of phrase used; they are called free structural expressions as an important factor of their stability distinguishes them from compound words; others names of their stability are stability in use, lexical stability and semantic stability; stability of use means that set phrases are treated as ready-made units, they are not members of structural style of speech; lexical stability means that the components of set phrases are either unchangeable or partly replaceable within a boundary of their stability; it distinguishes them from free phrases and other types of phrases; the lexical stability of set phrases is even more essential because the meaning of the phrase is preserved if they are used in different contexts; note phrases, weakened or strengthened in other words, are not set phrases; phrases, phraseological and phraseological units, as a separate class, they remain semantically invariant if are borrowed; they have to mention that most of these phrases are also mentioned by the linguistics. All of these ideas contribute to the method of phraseology definition which helps to figure out set phrases in all languages.

Phraseology (Phrasologie, Phrasenlehre, Phrasenlehre, etc.), which are theoretically based on their fields of study, respectively, syntax, word formation, morphology and semantics.

Significant research on the domain have already established the theoretical ground from both lexical-grammatical and lexical-semantic approaches by identifying common and distinctive features of these units in respect with other linguistic units. Still, the concept about phraseology sometimes is broader and sometimes not. In trying to define the boundaries of phraseology, we are examining some of the main principles, which are more or less accepted as axioms, as per our scholars. The following tendencies are identified from these ideas: phraseology is considered as a separate branch of linguistics and not as part of lexicology; phraseology deals with a subsystem of language, and not with related phraseological units; phraseology is concerned with a variety of set phrases; set phrases fall into three main classes: *free phrases*, *phraseological* and *phrase-grammatical units* or *border-line cases* (*free phrases* and *border-line cases*); the main distinctive feature of phraseology is semantic; phraseological idioms have both literal and non-literal meanings, while components of phraseology are used as their literal meanings.